

ATEIZMI: MOHIMI I TIJ, SHPRESA JONË E VETME!

Në vitin 1917, ndërsa këmbësoria e ushtrisë amerikane po përgatitej për betejë në fushat e Francës dhe Belgjikës, Shoqëria Biblike e Nju Jorkut i kërkoi Teodor Rusveltin (në atë kohë president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës) të shkruante shkurtimisht një mesazh që do t'u bashkangjitej kopjeve të Dhjatës së Re që do t'u dërgoheshin këtyre ushtarëve. Rusvelti e demonstroi karakterin e tij të mrekullueshëm përmes mesazhit që shkroi:

Mësimet e Dhjatës së Re na janë parathënë në vargun e profetit Mikea: «Çfarë gjë tjetër kërkon nga ty veçse të jesh i drejtë, të kesh mëshirë dhe të ecësh me përrulje ndaj Tij?»

Jini të drejtë dhe si rrjedhim luftoni më me trimëri kundër...atyre kombeve që gjatë kësaj krize po mbrojnë mbretërimin e Molekut dhe të Beel-Zebubit në këtë tokë.

Kini mëshirë, trajtojini mirë të burgosurit, ndihmoni të plagosurit, trajtoni çdo vajzë apo grua sikur të ishte motra juaj, kujdesuni për fëmijët e vegjël dhe jini të sjellshëm me më të moshuarit dhe me ata që vuajnë.

Ecni me përrulsi. Do ta bëni këtë kur të studioni jetën dhe mësimet e Shpëtimtarit.

Unë lutem që Perëndia i drejtësisë dhe i mëshirës t'iu mbrojë.

Forma më e përkryer e qeverisjes nuk mund ta mbrojë kombin nga shkatërrimi n.q.s ne si komb, si individë nuk kemi përbrenda një shpirt. Të mirat e shumta materiale nuk mund të na ndihmojnë në qoftë se ndjenjat tona shpirtërore veniten. Armiqtë e kombit tonë natyrisht që do të na nënshtrajnë, n.q.s nuk gjendet në njerëzit tanë një jetë e brendshme që reflektohet në moralin që nuk është shumë i ndryshëm nga ai i predikuar nga profetët dhe mësuesit e Testamentit të Vjetër, shumë kohë para viteve të lavdishme të Greqisë apo Romës së lashtë.

Ish presidenti Rusvelt kishte të drejtë kur tha se mbijetesa e një kombi është e lidhur në mënyrë të pashmangshme me themelet e moralit mbi të cilin qëndron ky komb. Një shoqëri që nuk qëndron mbi themelet e moralit të vëretë është e destinuar të përfundojë në kaos dhe anarki. Ky pohim është vërtetuar nga historia. Kombe të fuqishme arrijnë majën e fuqisë dhe të begatisë së tyre dhe më pas pllakosen nga kaosi dhe korrupsioni, sepse humbasin bazat e moralit. Kjo e vërtetë paraqet dobësinë e fundit të ateizmit. Ateizmi është një filozofi që nuk përmban asnjë lloj morali! Dhe për shkak të kësaj, ateizmi të udhëheq vetëm drejt kotësisë dhe dëshpërimit.

A ka ndonjë shpresë për një shoqëri që është e mbushur me mësimet e ateizmit? Kjo pyetje u bë nga profeti fshatar Mikea. Situata e trishtueshme e Mikeas 7:1–2 është e zakonshme sot: «Njeriu i përrshpirtshëm është zhdukur nga dheu, midis njerëzve nuk ka më njerëz të ndershëm....» Mikea profetizoi me Isaian për Mbretërinë Jugore të Judesë. Këta dy profetë jetonin në një shoqëri të zotëruar nga zilia, padrejtësia, mashtrimi dhe gënjeshtria. Korrupsioni ishte përhapur kudo, nga priftërinjtë të gjykatësit dhe deri te profetët e rremë. Shoqëria, në të cilën jetonin, nuk kishte aspak respekt për Perëndinë dhe vullnetin e Tij. Mikea na dha një pamje të plotë të një shoqërie ateiste. Një komb që e mohon Perëndinë nuk do të jetë në gjendje të provojë mëshirën e Tij (6:3), Njerëzit që e përbëjnë

këtë komb janë shumë agresivë në përpjekjet e tyre për t'u pasuruar në kurriz të bashkëqytetarëve (6:10–11) dhe qytetet e këtij kombi do të jenë të mbushura me ligësi, me dhunë dhe me sëmundje (6:12–13). Siguria e këtij kombi do të dobësohet dhe gëzimi i tij do të humbasë (6:14), e ardhmja e kombit është vetëm shkatërrim dhe shpërbërje (6:16). Konkluzioni i tmerrshëm i Mikeas 7:1–6 paraqet tragjedinë e filozofisë ateiste. Cili dëshiron të jetojë në një shoqëri të tillë?

Fatkeqësisht, shumë shoqëri bashkëkohore si ajo amerikane, shqiptare apo shumë të tjera ngjasojnë shumë me Mbretërinë Jugore në kohën e Mikeas. Në Shqipëri në këto momente dhuna është e kudogjendur, korrupsioni ka përfshirë këdo dhe marrëdhëniet midis njerëzve bazohen, në përgjithësi, vetëm në interesat materiale. Juda përdori një sërë metodash për të kuruar sëmundjet e saj, por asnjëra nuk dha sukses (Mikea 6:1–7). Neve, gjithashtu, na ofrohen lloje të ndryshme kurash për të shëruar «sëmundjet» e shoqërisë së sotme shqiptare. Por ashtu si Juda, kanceri i shoqërisë të sotme shqiptare nuk mund të kurohet me metoda çfarëdo. Kjo sëmundje do ta shkatërrojë kombin në qoftë se nuk ndalohet menjëherë. Sidoqoftë, shpresa ekziston për shoqërinë shqiptare! Megjithëse në atë gjendje të keqe, prapë kishte shpresë për Judën. Pikërisht, në mes të kësaj tragjedie kombëtare të përshtuar në librin e Mikeas, shpresa u ofrua. Mikea 6:8 ofroi një «kurë» për sëmundjen e Judas dhe kjo kurë është e njëjtë me atë që i nevojitet shoqërisë së sotme shqiptare.

KURA E SUGJERUAR

Mikea tha se mirëqënia e njeriut dhe e kombit varet nga ndjekja me besnikëri e tre parimeve (Mikea 6:8). Studjoni çdo parim dhe shikoni se si ndihmon ai në «kurimin» e sëmundjes që, po nuk u kurua, do ta shkatërrojë Shqipërinë dhe, më gjerë, gjithë njerëzimin.

E para, «zbatoni drejtësinë»! Kjo kërkon që ligjet të cilat janë bërë për të sjellë drejtësi dhe barazi në vend të respektohen në mënyrë absolute. Drejtësia është një koncept i përdorur shpesh në Bibël (Romakëve 2:11–24; Jakobi 2:8–13). Ata që abuzojnë, paragjykojnë dhe luajnë me drejtësinë nuk do t'i shpëtojnë dënimit. Gjithë njerëzit kërkojnë «drejtësi». Ajo është një e drejtë e pamohueshme e gjithë njerëzve, por kjo «drejtësi» nuk mund të

bëhet realitet nëse njerëzit nuk njohin atë që është «e mirë, e ndershme dhe drejtë». Me pak fjalë, «drejtësi» do të thotë: «të bësh atë që është e drejtë». Drejtësia nuk mund të përkufizohet ndryshe! Kjo është arsyeja që Perëndia u drejtohet njerëzve: «Respektoni të drejtën dhe zbatoni drejtësinë,... Lum njeriu që vepron kështu» (Isaia 56:1–2; Amos 5:24).

Asnjë shoqëri nuk mund të përparojë në qoftë se nuk synon dhe nuk zbaton mirësinë dhe drejtësinë. Kjo është një e vërtetë e thjeshtë, që shpesh anashkalohet. «Drejtësia» mund të përkufizohet vetëm duke iu referuar «mirësisë». Ateizmi, kur mohon Perëndinë, e heq «mirësinë» nga morali. Pra ateizmi na lë pa ndonjë themel për «drejtësinë».

Sfera e «drejtësisë» shpesh anashkalohet nga besimtarët. Duket sikur shumë kristianë e kanë bindur veten se ata nuk kanë pse të përfshihen në sferën e drejtësisë gjyqësore apo në skenën politike. Si rrjedhim, ne jo vetëm që i kemi dhënë Çezarit atë që është e tij, por gjithashtu i kemi dhënë edhe atë që është e Perëndisë. Ky lloj mentaliteti nuk është biblik. Bibla na mëson se njeriu u krijua për të «drejtuar» punët këtu në tokë (Zanafilla 1:28). Kristianët duhet të ndikojnë në shoqëri për mirë (1 Pjetër 1:13–16, 2:11). Pra, duhet të luftojmë për drejtësi dhe mirësi nëpërmjet kanaleve qeveritare (1 Mbretërve 10:9). Bibla është e qartë, Perëndia nuk do që ndjekësit e Tij të jenë të izoluar dhe të paditur rreth qeverisjes së një kombi.

Pasojat janë tronditëse, kur kristianët nuk kontribuojnë në ushtrimin e «drejtësisë». Jo-besimtarët, duke përfituar nga heshtja e besimtarëve, e kanë ndryshuar moralin dhe vlerat e shoqërisë sipas interesave të tyre. Për shembull, njerëzit për hir të interesave të tyre bëjnë gjëra nga më makabret. Fëmijët e palindur vriten (përmes abortit), familjes i ka humbur kuptimi i vërtetë dhe ajo që është e shenjtë përqeshet dhe përçmohet! Në qoftë se duam ta shpëtojmë shoqërinë tonë, duhet të mbrojmë dhe zbatojmë drejtësinë ashtu si na mëson Bibla (Jobit 29:14).

E dyta, të tregojmë mirësi ndaj të tjerëve, mirësi që buron nga dashuria. Ky është një shqetësim i kuptueshëm i njerëzve me halle. Rusvelti bënte fjalë pikërisht për këtë mirësi: «Trajtoni mirë të burgosurit, ndihmoni të sëmurët, trajtoni çdo grua apo vajzë sikur të ishte motra juaj, kujdesuni për fëmijët e vegjël dhe jini të sjellshëm me të moshuarit

dhe me të vuajturit.» Mëshira është ajo që e dallon fenë «e pastër» (Jakobi 1:27), mposht egoizmin (Filipianëve 2:4) dhe ofron «kurajon» (2 Korintasve 1:3–7). Pra, përsëri, filozofia ateiste e heq këtë faktor të rëndësishëm nga «kura» e saj për sëmundjen e rëndë të shoqërisë. Mësimet thelbësore të ateizmit e mohojnë praninë e Perëndisë, në këtë mënyrë ato anullojnë çdo mbështetje për moralin. Ateizmi, kur vihet në praktikë, e mohon vlerën e mëshirës. Mbrojtja që i bën ateizmi «vrasjes së mëshirshme» (siç quhet ndryshe vrasja e fëmijëve të palindur përmes abortit) është vetëm një emërtim i gënjeshtërt, sepse aty nuk ka asnjë lloj mëshire! «Mëshira» është ajo cilësi që e ka fuqizuar një komb si Amerikën. Mëshira ka inkurajuar ngritjen e spitaleve dhe shtëpive për fëmijë dhe ka themeluar organizata bamirëse dhe misione humanitare. Mëshira është në themel të gjithë shërbimeve që bëhen për të mirën e njeriut. Gjithçka e mirë buron nga mëshira që vjen nga besimi në Perëndi, por që mungon në filozofinë ateiste!

E treta, «ecni me përlulje përpara Perëndisë». Kjo i referohet pranimit të dobësisë njerëzore dhe të plotfuqishmërisë së Perëndisë (Veprat 10:34–35; Fjalët e Urta 1:7). Çdo civilizim që nuk do të pranojë fuqinë e Perëndisë do të zhduket. Historia ka nxjerrë të vërtetë vargun e Biblës që thotë: «Lum ai komb që ka Perëndi Zotin» (Psalmeve 33:12) apo vargun tjetër «Drejtësia e larton një komb, por mëkati është turpi i popujve» (Fjalët e Urta 14:34). Ai komb që nderon Perëndinë do të marrë këto shpërblime. Ai do të jetë gjithnjë i bekuar (Psalmeve 115:13). Gjykimi se çfarë roli ka luajtur Amerika në historinë botërore akoma nuk është i qartë. Sëmundja e shoqërisë do ta çojë atë drejt shkatërrimit në qoftë se nuk rikthehet ndjenja e përluljes përpara Perëndisë ndër amerikanët.

Nevoja për të qenë i përlulur theksohet në këtë koment të Xhorxh Uashingtonit (ish president i SHBA): «Është detyrë e të gjithë kombeve që të njohin pushtetin e Perëndisë së plotfuqishëm, t'i binden vullnetit të Tij, të jenë mirënjohës për bekimet që vijnë nga Ai dhe me përlulje të pranojnë mbrojtjen e Tij dhe të jetojnë duke ia patur frikën.» Ateizmi kurrë nuk mund të lejojë që një civilizim të jetë i përlulur përpara të Plotfuqishmit! Ateizmi në vend të përluljes preferon më shumë krenarinë. Një gjë e tillë rezulton vetëm në rrënim dhe dëshpërim, ashtu siç e vërtetoi edhe Nebukadnetsari kur ndoqi

krenarinë dhe jo përlulësinë (Danieli 4:30–33). Një fat i tillë i pret të gjithë ata që nuk jetojnë me përlulësi përpara Perëndisë.

KURA U GJEND

Pasi kemi parë shkaqet e sëmundjes dhe pasi kemi menduar për kurën e dhënë, ne do të studiojmë tani fjalët e Mikeas ku ai shpjegon se shpresa për një kurë ekziston! Gjendja e mjerueshme e dëshpërimit mund të kalojë! Profeti kishte shpresë për njerëzit e Perëndisë dhe sipas fjalëve të tij njerëzit e sotëm në të njëjtën mënyrë mund ta gjejnë shpresën. Kapitulli i fundit e Mikeas inkurajon kombet që ecin larg rrugës së Perëndisë ta kthejnë shikimin e tyre nga Perëndia dhe të jetojnë duke patur një besim të vërtetë tek Ai. Ai shkroi: «Por unë do të shikoj te Zoti, do të shpresoj te Perëndia i shpëtimit tim; Perëndia im do të më dëgjojë» (7:7). Ata që ndjekin këshillën e trefishtë të 6:8 do të zbulojnë gëzimin dhe fitoren: «...Ai do të mbrojë çështjen time dhe do të vendosë drejtësi për mua; ai do të më nxjerrë në dritë» (7:9). Ata që e refuzojnë kurën duke mohuar Perëndinë do të mbeten me turp: «Atëherë armikja ime do ta shohë dhe do të mbulohet me turp, ajo që më thoshte: “Ku është Zoti, Perëndia yt?” Sytë e mi do ta shikojnë me endje, ndërsa do ta shkulin si baltën e rrugëve» (7:10). Përmes Nebukadnetsarit shpjegohet mundësia për të shpëtuar nga dëshpërimi i mjerueshëm. Ai mohoi këshillën e Perëndisë për shkak të krenarisë të tij. Kjo bëri që ai të përfundonte në dëshpërim të plotë derisa u drejtua me fytyrë nga lart dhe pranoi fuqinë e Perëndisë (Danieli 4:34–37).

Të shërohesh nga një sëmundje tragjike është gjë e mrekullueshme. Lajmi më i mirë që njerëzit mund të dëgjojnë sot është mundësia që ata kanë për të shpëtuar nga dëshpërimi i mjerueshëm i ateizmit. Por ky shpëtim do të vijë vetëm tek ata që janë të gatshëm të ushtrojnë drejtësi, që kanë mirësi, dashuri dhe tek ata që ecin me përlulje përpara Perëndisë! Në qoftë se njerëzit ndjekin këtë këshillë atëherë ata do të zbulojnë «kurën» e mrekullueshme (Mikea 7:17b–19).

KONKLUZIONI

Në botën tonë, të mbushur me dhunë dhe me të keqe, ka vetëm një shpresë: besimi në Perëndi dhe bindja ndaj Tij! Në qoftë se duam të jetojmë në një shoqëri që vepron me drejtësi, mëshirë dhe përlulësi,

duhet të fillojmë me veten dhe familjet tona. Është shumë e rëndësishme që të vlerësojmë me vëmendje sjelljen tonë ndaj Perëndisë. Le të respektojmë vullnetin e të Plotfuqishmit dhe si rrjedhim do të kemi drejtësi dhe mëshirë në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë dhe do të ecim me përvullësi përpara Perëndisë.

Xhorxh Uashington, «babai i Amerikës», në një nga fjalimet drejtuar shtetit të porsaformuar amerikan, tha:

Në këto momente lutem me përgjërëm, që Perëndia me mirësinë e Tij të bëjë që ne të gjithë ta duam drejtësinë, ta duam mëshirën dhe të sillemi me mirësi, përvullësi dhe qetësi mendore, të cilat ishin karakteristikat e Autorit Hyjnor të fesë sonë të bekuar (Jezu Krishtit), sepse nëse nuk e imitojmë atë, duke u bërë shembull për të tjerët, ne kurrë s'mund të shpresojmë që të jemi një komb i lumtur.

Le të kuptojmë çfarë sugjeron Uashingtoni me këto fjalë dhe mesazhin e Teodor Rusveltit për ushtarët amerikanë që po i drejtoheshin frontit

evropian gjatë Luftës së Parë Botërore. Të dy e dinin se madhështia e një kombi gjendet vetëm në respektimin e drejtësisë, në përdorimin e mëshirës dhe në varësinë që ai komb ka ndaj Perëndisë së plotfuqishëm. Fatkeqësisht këto tre parime nuk janë pjesë e jetës së shumë njerëzve në Shqipëri apo në shumë vende të tjera sot. Kjo është edhe rezultat i mësimëve të gënjeshtërt të ateizmit. Le ta njohim kotësinë e ateizmit. Shumë njerëz janë kundër ateizmit «teorikisht». Me fjalë ata e pranojnë ekzistencën e Perëndisë, sidoqoftë shumë prej tyre pranojnë «ateizmin praktik». Ata pretendojnë se besojnë në Perëndinë, por refuzojnë që t'i përvullen me bindje vullnetit të Tij! Lutja ime është që të gjithë njerëzit të njohin të Plotfuqishmin dhe të ndjekin urdhëresat e Tij.

O njeri, ai të ka bërë të njohur atë që është e mirë; dhe çfarë tjetër kërkon Perëndia nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përvullësisht me Perëndinë tënd? (Mikëa 6:8).

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: "*Perëndia kundër ateizmit*"
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara